Në bazë te nenit 50 të Ligjit për Vetqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e R.M.", nr. 5/2002 dhe "Gazeta Zyrtare e R.M.V. „ , nr. 202/2024), nenin 22-a të Ligjit pËr Sportin (29/2002, 66/2004, ..., 106/2016 dhe 190/2016 dhe "Gz. zyrtare e R.M.V.", nr. 98/2019, 244/2019, ..., 170/2024 dhe 59/2025), nenet 54, 55 dhe 56 të Statutit të Komunës së Likovës ("Fletore zyrtare e Komunës së Likovës", nr. 01/2006, 03/2015, 01/2019 dhe 12/2024), Buxheti i Komunës së Likovës për vitin 2026, Programa L0, zëri 463120, me nr. 08-1229/5 të dt. 09.12.2025, të miratuar nga Këshilli i Komunës së Likovës, Regulloren mbi mënyrën, kushtet, procedurën dhe realizimin e transfereve per mbështetje financiare të subjekteve dhe shoqatave në fushën e sportit, arsimit dhe shoqatave kulturore-artistike, nr. 08-1296/16 nga 24.12.2025, të miratuar nga Këshilli i Komunës së Likovës, Programit për Komunën e Likovës në fushën e Sportit për vitin 2026, me nr. 08-217/28 nga 27.02.2026, Vendimit për ndryshimin e rregullores për mënyrën, kushtet, procedurën dhe realizimin e transfereve për mbështetje financiare: për sport, arsim dhe shoqata kulturo-artistike 08-426/7 nga 21.04.2026 si dhe ndryshimin dhe plotësimin e programës për aktivitetet e Komunës së Likovës në fushën e Sportit për vitin 2026 me nr. 08-426/8 nga 21.04.2026 të miratuar nga Këshilli i Komunës së Likovës, Komuna e Likovës, shpall:

SHPALLJE PUBLIKE
për aplikim për fushën e Sportit për vitin 2026 - plotësuese

Komuna e Likovës shpall Thirrje Publike për ndarjen e mjeteve financiare për mbështetjen e shoqatave, klubeve sportive e tjerë që janë me seli në territorin e Komunës së Likovës, në pajtim me Vendimit për ndryshimin e rregullores për mënyrën, kushtet, procedurën dhe realizimin e transfereve për mbështetje financiare: për sport, arsim dhe shoqata kulturo-artistike 08-426/7 nga 21.04.2026 si dhe ndryshimin dhe plotësimin e programës për aktivitetet e Komunës së Likovës në fushën e Sportit për vitin 2026 me nr. 08-426/8 nga 21.04.2026 të miratuar nga Këshilli i Komunës së Likovës.

1. **Të drejtë aplikimi kanë:**

- Shoqata e gjuetarëve;
- Shoqata e boksit dhe kik-boksit, si dhe shoqata të tjera të sporteve luftarake
- Klubet dhe shoqatat sportive të regjistruara në përputhje me ligjin për Sport;
- Klubet dhe shoqatat që kanë seli në territorin e Komunës së Likovës dhe
- Subjektet që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Komunës së Likovës;

2. **Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim**:
   Aplikuesit duhet të dorëzojnë:

1. Kërkesë për financim (me përshkrim të shkurtër te projektit/aktiviteteve), e cila do jetë si shtojcë e kësaj shpallje;
2. Programin ose projektin e aktiviteteve në fushën e sportit per vitin 2026, të cilat planifikojne t'i realizojnë gjatë vitit rrjedhës,
3. Klubet sportive / shoqatat duhet të jenë të regjistruara në pajtim me Ligjin për shoqata (llogarinë rrjedhëse) jo më të vjetër se 6 muaj) dhe
4. Vërtetim për xhirollogarinë e klubit.

3.Mënyra dhe afati i aplikimit:

Aplikimet dorëzohen në arkivin e Komunës së Likovës ose me Postë në këtë adresë: Komuna e Likovës, f.Likovës, 1307, në afat prej 13 ditëve të punës, duke u llogarit edhe ditën e shpalljes, edhe atë jo më vonë se dt.18.06.2026.

Aplikimet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Shpallja publike do të publikohet në faqën zyrtare te Komuna e Likovës, përkatësisht në:
www.komunaelikoves.gov.mk

4. Procedura e përzgjedhjes:

Vlerësimin e aplikimeve do t'a bëjë Komisioni i formuar nga Kryetari i Komunës, ndërsa Vendimin për ndarjen e mjetëve do t'a sjellë Këshilli i Komunës së Likovës, dhe i njejti do të publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Likovës: **www.komunaelikoves.gov.mk**

Komuna e Likovës